

Abdesi, kushtet, kohët, rekatet dhe mënyra e faljes së namazit.

(Përgatiti dhe thjeshtësoi: Hfz. Ekrem ef. Hasani. Imam, hatib dhe mësimdhënës në QIKSHN, Oslo).

Vëllezër dhe motra të nderuara: po ua paraqesim në mënyrë të shkurtër por të detajuar mënyrën e faljes së namazit, duke shpresuar që do të na ndihmojë të gjithëve për t'u njoftuar më lehtë për faljen e namazit.

Namazi falet në pesë kohë:

- 1. Sabahu (prej pas agimit e deri para lindjes së diellit).**
- 2. Dreka (prej pas zenitit e derisa hija e një objekti të zgjatet sa objekti ose dy herë sa objekti).**
- 3. Iqindija (prej kur hija e objektit zgjatet një ose dy herë sa objekti e deri para perëndimit të diellit).**
- 4. Akshami (Pas perëndimit të diellit e deri kur erësira mbulon tokën).**
- 5. Jacija (prej kur kaplon erësira e deri para agimit).**

Rekatet e namazit.

Namazet e obliguara quhen Farze. Ndërsa namazet vullnetare quhen SUNETE ose NAFILE. Për namazet farze ka urdhëruar Allahu xh.sh. ndërsa namazet sunete Muhamed s.a.v.s. i ka falur vullnetarisht dhe ka porositur që të falen, dhe quhen Sunete të rregullta sepse i ka falur rregullisht bashkë me farzet.

Çdo kohë e namazit ka farze edhe sunete.

Namazi i Sabahut përbëhet prej 4 rekateve: 2 farze dhe 2 sunete.

Namazi i derkës ka 10 rekate: 4 sunete, 4 farze dhe 2 sunete të fundit.

Namazi i iqindisë ka 8 rekate: 4 sunete dhe 4 farze.

Namazi i akshamit ka 5 rekate: 3 farze dhe 2 sunete.

Namazi Jacisë ka 10 rekate: 4 sunete, 4 farze, 2 sunete. Ndërsa pas Jacisë falen edhe 3 rekate vaxhib të vitrit (Salati vitër).

Abdesi kusht i domosdoshëm për faljen e NAMAZIT.

Para çdo namazi merret abdes.

Abdesi është një ndër gjashtë kushtet përgatitore të namazit.

Allahu në Kur'anin famëlartë thotë:

O ju që besuat! Kur doni të ngriteni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjt...

Surja: El-Maide. Ajeti: 6.

Abdesi ka katër farze.

1. Larja e fytyrës.
2. Larja e krahëve deri mbi bëryla.
3. Fërkimi i pjesës së parme të kokës me dorë të lagur (Mes'h).
4. Larja e këmbëve deri mbi nyje.

Përveç farzeve abdesi ka edhe sunete e ato janë:

1. Larja e duarve deri në nyje.
2. Shpërlarja e gojës tri herë.
3. Larja e hundës tri herë.
4. Larja e veshëve, (me gishtin tregues lajmë brendinë e veshëve, ndërsa me gishtin e madh pjesën e jashtme të tyre) dhe me tre gishtat e fundit me shpinën e tyre e fshimë qafën.

Vërejtje! Nëse ngel ndonjë farz pa plotësuar qoftë me qëllim apo me harresë, duhet plotësuar pasi të të kujtohet se për ndryshe abdesi nuk vlen dhe namazi është i papranueshëm. Ndërsa, nëse ngel ndonjë sunet pa plotësuar, abdesi është në rregull.



Namazi dhe kushtet e tij.

Për të qenë namazi i vlefshëm duhet plotësuar 12 kushte 6 para se të hymë në namaz dhe 6 pasi të hymë në namaz.

Gjashtë kushtet para namazit konsiderohen përgatitja për namaz e ato janë:

- 1. Marrja e abdesit**
- 2. Të jetë i pastër trupi, teshat, dhe vendi ku do të falemi.**
- 3. Të jetë i mbuluar trupi (meshkujt sëpaku të kenë të mbuluar trupin prej kërthinzës e deri nën gjunj, ndërsa femrat të kenë të mbuluar tërë trupin në përjashtim të fytyrës, duarve deri në nyje dhe këmbëve deri në zogj).**
- 4. Namazi të bëhet në kohë të caktuar (Sabuhu në kohë të vetë, dreka në kohën e vetë,etj).**
- 5. Drejtimi kah kibla.**
- 6. Bërja e nijetit për namazin e kohës dhe llojin e namazit.**

Pasi të plotësohen këto gjashtë kushte hyhet në namaz.

Gjashtë kushtet brenda namazit quhen edhe RUKNET e namazit (shtyllat e namazit), e ato janë:

- 1. Tekbiri fillestarë (ngritja e duarve te veshët dhe shprehja e tekbitit ALLAHU EKBER.**
- 2. Qëndrimi në këmbë (kijam) d.m.th. namazi të kryhet në këmbë për ata që kanë mundësi. Ndërsa ata që nuk mund të qëndrojnë në këmbë falen ulur.**
- 3. Leximi i një pjese të caktuar të Kur'anit (kiraet).**
- 4. Përkulja (rukuë).**
- 5. Lëshimi i fytyrës në tokë (sexhde).**
- 6. Qëndrimi ulur në fund të namazit.**



Çka do me thënë "REKAT" në namaz?

Një qëndrim në këmbë, një lexim i një pjese të caktuar të Kur'anit, një përkulje (rukuë) dhe dy sexhde e përbëjnë një REKAT.

Rekati brenda tij ka farze, vaxhibe dhe sunete.

Shqiptimi i tekbirit në fillim të namazit është rukën (farz), ngritja e duarve afër veshëve dhe lidhja e duarve nën kërthinzë është sunet.

Leximi i subhanekes në fillim të namazit është sunet.

Leximi i një pjese nga Kur'ani është farz (rukën), ndërsa leximi i sures el-fatiha (elhamdulilahi) dhe pas saj një sure apo tre ajete të shkurtëra ose një ajet i gjatë është vaxhib.

Rukuja (përkulja) dhe dy sexhdet janë rukne (farz).

Shqiptimi i tesbihut (subhane rabbijel adhim 3 herë) në rukuë, dhe (subhane rabbijel aëla 3 herë) në sexhde, është sunet.

Në uljen e parë (pas dy rekateve) dhe në uljen e fundit leximi e teshehudit (ettehijjatu), është vaxhib, ndërsa salavatet dhe du'atë janë sunnet.

Vërejtje:

Farz, është urdhër i Allahut në mënyrë të prerë.

Vaxhib, është urdhër i Allahut por jo në mënyrë të prerë.

Sunet, është praktikë dhe porosi e Pejgamberit s.a.v.s.

Sqarim!

Për çdo lëshim të ndonjë farzi me harresë, duhet kthyer për ta plotësuar atë farz dhe në fund të namazit pas "ettehijatu" jepet selam vetëm në anën e djathtë, i bën dy sexhde, ulesh përsëri, lexon ettehijatu, salavatet, duatë dhe e përfundon me selam (kjo e ka emrin SEHVI SEXHDE- Sexhdja e harresës). Për ndryshe duhet përsëritur namazi. Për lëshimin ose vonimin e vaxhibit, nuk duhet rikthyer për ta plotësuar, por vetëm duhet bërë sexhde të harresës (sehvi sexhde).

Ndërsa sa i përket lëshimit të ndonjë suneti nuk nevojitet ndonjë përmirësim, plotësim ose sehvi sexhde.

Për më tepër sqarim na kontaktoni në privat.

1. Namazi i Sabahut dhe përbëhet prej 4 rekatesh: 2 sunnet dhe 2 farz.

Mënyra e faljes së namazit të Sabahut.

Sëpari falen dy rekatë sunet të Sabahut.

1. Bëhet nijeti (vendosja me zemër, por është mirë të shprehet edhe me gojë: "Vendosa për hirë të Allahut të falë sunnetin e Sabahut").

Rekati i I-rë.

2. Merret tekbi fillestarë duke e shprehur "Allahu ekber" dhe i ngrejmë duart afër veshëve për meshkujt, kurse femrat afër supeve të krahëve (shiko foton nr. 1.)

3. I lidhim duart duke vënduar dorën e djathtë mbi të majtën nën kërthinzë për meshkujt, ndërsa femrat mbi gjoks.

4. Lexojmë dovëm Subhaneke. Shiko foto nr. 2.

5. Lexojmë suren Fatiha (elhamdulilahi) shiko foto nr. 3.

6. Lexojmë një sure apo tre ajete. Shiko foto nr. 4.

7. Pas sures bëjmë rukunë. Shiko foto nr. 5. Në rukuë themi tri herë "Subhane rabijel adhim".

8. Pas rukus duke thënë "semiallahu limen hamideh, rabbena ve lekel hamd", drejtohem drejtë në këmbë dhe mandej lëshohemi në sexhde.

9. Në sexhde biem duke e lëshuar në tokë gjujtë, dy shuplakat e duarve, ballin me gjithë hundën dhe majat e gishtave të këmbëve d.m.th. shtatë gjymtyrë. Shiko foto nr. 6.

Në sexhde themi tri herë "subëhane ranbijel ea'la".

Pas dy sexhdeve ngritemi për rekatën e dytë.

Rekati II-të

1. I lidhim duartë si në fillim, lexojmë bismilahirrahmanirrahim, Fatihanë (elhamdulilahi), një sure (p.sh. Kulhuvallahu ehad, shiko foto nr. 7.).

2. Pas sures bëjmë rukunë.

3. I bëjmë dy sexhde dhe qëndrojmë ulur.

4. Në ulje lexojmë "ettehijjatu, salavatet dhe duatë Allahume rabbena dhe Allahume rabbenagfirli. Shiko foto nr. 8.

5. Pas duave jepet selam në anën e djathtë dhe në të majtë me fjalën: "Esselamu alejkum ve rahmetullah". Kështu përfundon falja e sunnetit të Sabahut.

Farzi i Sabahut.

Edhe Farzi i Namazit të Sabahut ka dy Rekatë dhe falet në të njejtën mënyrë si Sunneti. Dallimi qëndron vetëm te Nijeti-vendosja dhe se te Farzi meshkujt bëjnë Ikametën para se të fillojnë faljen e Farzit.


Ikameti.

Ikameti bëhet kështu:


ALLAHU EKBER 4 herë.

ESH'HEDU EN LA ILAHE ILALLAH 2 herë.

ESH'HEDU ENNE MUHAMMEDEN RASULULLAH 2 herë.
HAJJE ALESSALATI 2 herë.
HAJJE ALELEL FELAHI 2 herë.
KAD KAMETISSALATU 2 herë.
ALLAHU EKBER 2 herë.
LA ILAHE ILALLAH 1 herë.
Allahu ua pranoftë Namazin tuaj.



F. nr. 2



F. nr. 3

Subhaneke All-llahumme
ve bi hamdike
ve tebarekesmuke
ve te'ala xhedduke
ve la ilahe gajruke

www.femijetislam.com

Eudhu bilahi mine shejtanir-raxhim
Bismil-lahir-rahmanir-rahim
Elhamdulilahi rabbil alemin
Er-rahmanir-rahim
Maliki jewmi din
Ijake nabudu we ijake nesteain
Ihdines-siratal mustekim
Siratal ledhine en amte alejhim
Gajril magdubi alejhim we led dalin

F. nr. 4



1. In-na eatajna kel kewther
2. Fesal-li li rabike wenhar
3. In-ne shanieke huwel ebter

F. nr. 5






Foto nr. 6.



Foto nr. 7.



23. SJEDNEMO I UČIMO
ETTEHIJJATU, SALAVATE I DOVE

Ettehijjatu lillahi vessalavatu ve
ttajjibatu esselamu alejke ejuhen
nebijju ve rahmetullahi ve berekatuhu,
esselamu 'alejna ve 'ala 'ibadillahi ssalihin
Ešhedu en la ilabe illellah ve Ešhedu
enne Muhammeden abduhu ve resuluh

Allahumme Salli 'Ala Muhammedin Ve 'Ala Ali Muhammedin Kema
Sallejte 'Ala Ibrahim Ve 'ala Ali Ibrahim Inneke Hamidum Medžid.
Allahumme Barik 'Ala Muhammedin Ve 'Ala Ali Muhammid Kema
Barekte 'Ala Ibrahim Ve 'Ala Ali Ibrahim Inneke Hamidum Medžid.



24. DOVE GLASE:

Allahumme Rabbena Atina
Fi ddun'ja Haseneten
Ve Fil Ahireti Haseneten
Vekina Azabennar.
Rabbenagfir Li Veli validejje
ve Lil Mu'minine Jevme
Jekumul Hisab.

Foto nr. 8

2. Namazi i Drekës dhe përbëhet prej 10 rekateve: 4 sunnet, 4 farz dhe 2 sunnet të fundit.

- Katër sunnetet e parë.

1. Nijeti (vendosja).
2. Leximi i subëhanekes.
3. Eudhu bilahi mineshejtanirraxhim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)
4. Rukuë.
5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde.
4. Ulja e parë. Leximi ettehijjatu, ngritemi për rekatin e tretë.

Rekati i III-të.

1. Bismilah..., elhamdulilahi, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabil felek.
2. Rukuë
3. Dy sexhde
4. Ngritemi për rekatin e katërt.

Rekati i IV.

1. Bismilahi, elhamdulilah, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabinnas.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde
4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfir li.
5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

- Katër farzet e namazit të Drekës.

(Meshkujt për farzin sëpari bëjnë Ikametin).

1. Nijeti (vendosja).
2. Leximi i subëhanekes.
3. Eudhu bilahi mineshejtanirraxhim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)
4. Rukuë.
5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde.
4. Ulja e parë. Leximi ettehijjatu, ngritemi për rekatin e tretë.

Rekati i III-të.

1. Bismilah..., vetëm elhamdulilahi.

2. Rukuë
3. Dy sexhde
4. Ngritemi për rekatin e katërt.

Rekati i IV.

1. Bismilahi, vetëm elhamdulillah.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde
4. Ulja e fundit. Leximi ettehiatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfir li.
5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

- Dy sunnetet e fundit të Drekës.

1. Nijeti (vendosja).
2. Leximi i subëhanekes.
3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajname...)
4. Rukuë.
5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde.
4. Ulja e fundit. Leximi ettehiatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfirli.
5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

Kështu përfundon Namazi i Drekës.

Allahu ua pranoftë!

3. Namazi i Iqindisë dhe përbëhet prej tetë rekateve: 4 sunnete dhe 4 farze.

Sunneti i Iqindisë llogaritet prej sunneteve jo të forta (gajri muekede), d.m.th. ka patur raste që Muhamedi s.a.v.s. për ndonjë arsye i ka lënë pa falur.

- Suneti i Iqindisë falet sikurse suneti i Drekës por me disa dallime.

1. Nijeti (vendosja).
2. Leximi i subëhanekes.
3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajname...)

4. Rukuë.

5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatën e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde.

4. Ulja e parë. Leximi ettehijjatu, Allahumme sali ala Muhamed dhe Allahumme barik ala Muhammed (këtu qëndron dallimi mes sunetit të drekës dhe të iqindisë), mandej ngritemi për rekatën e tretë.

Rekati i III-të.

1. Subëhaneke, eudhu bilah... (edhe këtu është dallimi prej sunetit të Drekes), Bismilah..., elhamdulillah, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabil felek.

2. Rukuë

3. Dy sexhde

4. Ngritemi për rekatën e katërt.

Rekati i IV.

1. Bismilahi, elhamdulillah, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabinnas.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde

4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfir li.

5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

- Farzet e namazit të Iqindisë.

1. Nijeti (vendosja).

2. Leximi i subëhanekes.

3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)

4. Rukuë.

5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatën e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde.

4. Ulja e parë. Leximi ettehijjatu, ngritemi për rekatën e tretë.

Rekati i III-të.

1. Bismilah..., vetëm elhamdulillah.

2. Rukuë

3. Dy sexhde

4. Ngritemi për rekatën e katërt.

Rekati i IV.

1. Bismilahi, vetëm elhamdulillah.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde

4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfirli.

5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.
Kështu përfundon Namazi i Iqindisë.
Allahu ua pranoftë!

4. Namazi i Akshamit dhe përbëhet prej 5 rekateve: 3 fare dhe 2 sunnete.

- Farzet e namazit të Akshamit.

(Meshkujt për farzin sëpari bëjnë Ikametin).

Rekati i I-rë

1. Nijeti (vendosja).
2. Tekbiri fillestarë dhe leximi i subëhanekes.
3. Eudhu bilahi mineshejtanirraxhim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)
4. Rukuë.
5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde.
4. Ulja e parë. Leximi ettehijjatu, ngritemi për rekatin e tretë.

Rekati i III-të.

1. Bismilah..., vetëm elhamdulillah.
2. Rukuë
3. Dy sexhde
4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfir li.
5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

- Suneti i Akshamit.

Rekati i I-rë.

1. Nijeti (vendosja).
2. Tekbiri fillestarë dhe leximi i subëhanekes.
3. Eudhu bilahi mineshejtanirraxhim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)
4. Rukuë.
5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.
2. Rukuë.
3. Dy sexhde.
4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed,

Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfirli.

5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

Kështu përfundon Namazi i Akshamit.

Allahu ua pranoftë!

5. Namazi i Jacisë dhe përbëhet prej 10 rekateve: 4 sunnete, 4 farze dhe 2 sunnete të fundit.

- Sunnetet Jacisë.

1. Nijeti (vendosja).

2. Tekbiri fillestarë. Leximi i subëhanekes.

3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)

4. Rukuë.

5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde.

4. Ulja e parë. Leximi ettehijatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed dhe Allahume barik ala Muhammed) mandej ngritemi për rekatin e tretë.

Rekati i III-të.

1. Subëhaneke, eudhu bilai...bismilah..., elhamdulilahi, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabil felek.

2. Rukuë

3. Dy sexhde

4. Ngritemi për rekatin e katërt.

Rekati i IV.

1. Bismilahi, elhamdulilah, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabinnas.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde

4. Ulja e fundit. Leximi ettehijatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfir li.

5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

- Farzet e namazit të Jacisë.

(Meshkujt për farzin sëpari bëjnë Ikametin).

1. Nijeti (vendosja).

2. Tekbiri fillestarë. Leximi i subëhanekes.

3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulilahi, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)

4. Rukuë.

5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde.

4. Ulja e parë. Leximi i ettehijjatu, ngritemi për rekatin e tretë.

Rekati i III-të.

1. Bismilah..., vetëm elhamdulillah.

2. Rukuë

3. Dy sexhde

4. Ngritemi për rekatin e katërt.

Rekati i IV.

1. Bismilahi, vetëm elhamdulillah.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde

4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfir li.

5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

- Suneti i fundit i Jacisë.

1. Nijeti (vendosja).

2. Tekbiri fillestarë. Leximi i subëhanekes.

3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)

4. Rukuë.

5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde.

4. Ulja e fundit. Leximi ettehijjatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfirli.

5. Selam në anën e djathtë dhe në të majtë.

Kështu përfundon Namazi i Jacisë.

- Pas Namazit të Jacisë falim edhe tre rekatë vaxhib të Vitrit.

Namazi i vitrit nuk është pjesë e namazit të jacisë por namaz i veçant i cili falet pas namazit të jacisë dhe falet në këtë mënyrë:

Rekati i I-rë

1. Nijeti (vendosja).

2. Tekbiri fillestarë dhe leximi i subëhanekes.

3. Eudhu bilahi mineshejtanirrahim bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure (p.sh. inna ea'tajnake...)

4. Rukuë.

5. Dy sexhde dhe mandej ngritemi për rekatin e dytë.

Rekati i II-të.

1. Bismilahirrahmanirrahim, elhamdulillah, një sure p.sh. Kulhuvallahu ehad.

2. Rukuë.

3. Dy sexhde.

4. Ulja e parë. Leximi ettehijatu, ngritemi për rekatin e tretë.

Rekati i III-të.

1. Bismilah..., elhamdulillah, një sure p.sh. Kul eudhu bi rabil felek.

2. Pas sures i ngritim duart si në tekbinin fillestarë, i lidhim përsëri dhe lexojmë du'anë e Kunutit (Allahumme inna nesteinuke... dha Allahumme ijake na'budu...)

3. Rukuë

4. Dy sexhde

5. Ulja e fundit. Leximi ettehijatu, salavatet (Allahumme sali ala Muhamed, Allahumme barik ala Muhammed, Allahumme Rabena atina, Allahumme Rabenagfirli.

6. Selam në anën e djathtë dhe në të majtëSqarim: Është mirë që në rekatin e parë të lexohet surja ea'la (sebbihisme rabike...), në rekatin e dytë surja elkafirun, ndërsa në rekatin e tretë surja ihlas-kul huvallahu e had.

Allahu ua pranoftë!

Namazi i Xhumasë.

Namazi i xhumasë përbëhet prej dhjetë rekateve, 4 sunnete, 2 farze dhe 4 sunnete të fundit. Sunetet falen njëloj si sunnetet e Drekës.

Pas sunneteve të fundit të xhumasë falet Farzi i drekës së fundit (ahiri dhuhri). Kjo falet si Dreka alternative për shkak të faljes së xhumasë në shumë xhamia të një qyteti apo fshati gjë që sipas disa transmetimeve, nuk lejohet të falet xhumaja përpos në një vend të qytetit. Transmetohet nga Imam Shafiu: "Nuk falen dy namaze të xhumasë në një qytet, edhe nëse është qyteti i madh". Gjithashtu, edhe nëse eventualisht xhumaja nuk i ka plotësuar kushtet e saja për obligueshmërinë ose për vlefshmërinë e saj, atëherë "ahiri dhuhri - dreka e fundit" e zen vendin e asaj dite.

E nëse xhumaja i ka plotësuar të gjitha kushtet, atëherë "ahiri dhuhri - dreka e fundit" përmbush shprazëtirën e drekës së fundit të pa falur (Kaza). Ky është mendimi i dijetarëve të Medh'hebit Shafij dhe Hanefij. Prandaj në shumë vende të botës muslimanët pas sunnetit të dytë të xhumasë falin edhe "ahiri dhuhrit - drekën e fundit". Allahu ea'lem - Allahu e di më së miri.

Pas "ahiri dhuhrit-drekës së fundit falen edhe dy rekate "sunnete të kohës". Të gjitha këto kanë bazë por varet nga studiuesit e Shkollave Juridike Islame si i vlerësojnë dhe çfarë vendimi japin për to, sepse të gjithë ata kanë argumentet e tyre.

Vërejtje!

Namazi i xhumasë është shumë i vlefshëm, edhe dëgjimi i Hutbes është shumë me rëndësi dhe, nuk lejohet të bisedohet me dikë kur hatibi mban hutben. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Nëse i thua shokut "hesht" kur hatibi mban hutben, ti i ke humbur sevapet - shpërblimet e xhumasë.

Allahu ua pranoftë Namazin e Xhumasë.

Disa udhëzime dhe këshilla që duhet praktikuar ditën e xhuma.

